REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr 1068 Prot

Maliq më 19 /02/2026

PROJEKT-VENDIM

Nr 14 datë 19.02.2026

PËR "MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË MALIQ, 2026-2028"

Në mbështetje të ligjit nr. *139/2015 datë 17.12.2015,* "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të nenit 8 pika 1 dhe 2 ,nenit 9,pika 1,nënpika 1.1,neni 64 "Detyrat dhe kompetencat e kryetarit të bashkisë"gërma"c",neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak"gërma "k",VKM nr.859 datë 26.12.2024 për "Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2024-2030",Planit të veprimit 2024-2026 ,Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për NJVV, grupi I punës I ngritur me vendim nr 118,datë 30.09.2025 i propozojmë miratimin e këtij projekt-vendimi nga këshilli duke vendosur :

1.Të miratojë Planin e Integritetit në Bashkinë Maliq 2026-2028, i hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe metodologjinë përkatëse. Dokumenti përfshin objektivat strategjikë, masat përkatëse, afatet e zbatimit dhe indikatorët e monitorimit.

2. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit ka për detyrë të monitorojë zbatimin e Planit të Integritetit, vecanërisht planin e veprimit për menaxhimin e riskut të integritetit të Bashkisë Maliq për veprime që mund të ndodhin dhe mund të cojnë në cënimin e integritetit të Institucionit.

3. Të gjitha strukturat, me kërkesë të personit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit, duhet të dorëzojnë të dhëna dhe informata të një rëndësie të nevojshme për zbatimin e tij, të cilat nuk janë në kundërshtim me rregulloren e brendshme të institucionit .

4. Njësitë përgjegjëse do të raportojnë çdo 6 muaj mbi progresin e zbatimit të masave të planit, ndërsa raporti vjetor publikohet në faqen zyrtare të bashkisë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha strukturat drejtuese në bashki.

6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Këshilli Bashkiak.

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

1068 19.2.26

RELACION

PËR "MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË MALIQ, 2026-2028"

Të nderuar këshilltarë të Këshillit të Bashkisë Maliq!

Në mbështetje të ligjit nr. *139/2015 datë 17.12.2015,*"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të nenit 8 pika 1 dhe 2 ,nenit 9,pika 1,nënpika 1.1,neni 64 "Detyrat dhe kompetencat e kryetarit të bashkisë"gërma"c",neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak"gërma "k",VKM nr.859 datë 26.12.2024 për "Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2024-2030",Planit të veprimit 2024-2026 ,Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për NJVV, grupi i punës i ngritur me Vendim Këshilli Bashkiak nr 118,datë 30.09.2025 paraqitet për miratim Plani i Integritetit të Bashkisë Maliq për periudhën 2026–2028.

Procesi i hartimit është kryer nga grupi i punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë miratuar me vendim keshilli Bashkiak, në bashkëpunim me AMVV. Gjatë procesit janë zhvilluar fokus-grupe me drejtoritë, analiza e kuadrit rregullator dhe anketimi i 44 punonjësve të administratës, duke garantuar një qasje gjithëpërfshirëse.

Plani adreson risqet e identifikuara në shtatë fushat kryesore: menaxhimi financiar, buxheti & prokurimi, administrimi i pronave, burimet njerëzore, planifikimi urban, shërbimet publike dhe kontrolli i brendshëm.

Objektivat kryesorë të planit janë:
- Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe etik;
- Konsolidimi i burimeve njerëzore dhe rritja e kapaciteteve profesionale;
- Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit institucional.

Plani parashikon masa konkrete, afate zbatimi, përgjegjësi dhe buxhet indikativ, duke respektuar kufirin ligjor prej 1% të buxhetit vendor. Zbatimi i tij parashikon raportim periodik çdo 6 muaj dhe publikim vjetor të ecurisë.

Duke vlerësuar rëndësinë e këtij dokumenti strategjik për forcimin e integritetit institucional, kërkohet miratimi i Planit të Integritetit 2026–2028 nga Këshilli Bashkiak Maliq.

Ju faleminderit !

Konceptoi : J.Xhialli Sekretar i Pergjithshem

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ